KCDE - Mëso Online
Kosova Center for Distance Education

Canada

NDARJA GJINORE E MËSIMIT NË DISTANCË NË KOSOVË

GJATË PANDEMISË COVID-19

2020/21

CANADA FUND FOR LOCAL INITIATIVES
EMBASSY OF CANADA TO CROATIA AND KOSOVO

Financuar nga: Canada

DEKLARATË MOHIMI

"Ky hulumtim u mundësua nga Programi i Fondit Kanadez për Iniciativa Lokale, fasilituar nga Ambasada e Kanadës në Kroaci dhe Kosovë. Përmbajtja është përgjegjësi e Kosova Center for Distance Education (KCDE) - Mëso online, dhe nuk pasqyron pikëpamjet e Fondit Kanadez për Iniciativa Lokale (CFLI), Ambasadës Kanadeze në Kroaci dhe Kosovë ose Qeverisë Kanadeze".

Autorët:
Antigona Uka, Marigona Morina

Kontribuesit:
Fridon Lala, Gjina Kaçaniku, Arbenita Krasniqi

Redaktor:
Jake McGrew

Origjinali është shkruar në gjuhën Angleze

Publikuar nga: KCDE - Mëso Online
Kosova Center for Distance Education

Kosova Center for Distance Education-Mëso Online
www.mesoonline-ks.org

E drejta autoriale © 2020 nga KCDE - MESO ONLINE. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të reproduktohet, të ruhet në ndonjë sistem reproduktimi apo të transmetohet, në asnjë formë apo nga asnjë mjet, qoftë elektronikapo mekanik, fotokopjues, regjistrues apo tjetër, pa lejen paraprake me shkrim nga botuesi.

TABELA E PËRMBAJTJES

1 Përmbledhja Ekzekutive

2 Hyrje

3 Përmbledhje e Hulumtimit Ekzistues

4 Metodologjia

5 Analiza

6 Implikimet e Politikave

7 Konkluzioni dhe Rekomndimet

LISTA E TABELAVE

TABELA 1. NUMRI I PËRGJITHSHËM I NXËNËSVE TË REGJISTRUAR PËR VITIN AKADEMIK 2019/2020.

TABELA 2. PËRQINDJA E NXËNËSVE NGA KOMUNAT E MËDHA TË CILËT NUK VIJUAN MËSIMIN ONLINE

TABELA 3. PËRQINDJA E NXËNËSVE NGA KOMUNAT E VOGLA TË CILËT NUK VIJUAN MËSIMIN ONLINE

TABELA 4. PËRQINDJA E NXËNËSVE JO-PJESËMARRËS NË MËSIMIN NË DISTANCË SIPAS NIVELIT TË SHKOLLËS DHE KOMUNËS (SHTESË)

TABELA INFOGRAFIKE

01
Struktura gjinore në arsimin parafillor sipas 2018/19

02
Pjesa e nxënësve meshkuj dhe femra në institucionet arsimore

03
Pjesa e përqindjes midis jo-pjesëmarrësve, Komuna e Prishtinës

04
Pjesa e përqindjes midis jo-pjesëmarrësve, Komuna e Prizrenit

05
Pjesa e përqindjes midis jo-pjesëmarrësve, Komuna e Pejës

06
Pjesa e përqindjes midis jo-pjesëmarrësve, Komuna e Gjakovës

07
Pjesa e përqindjes midis jo-pjesëmarrësve, Komuna e Mitrovicës

08
Pjesa e përqindjes midis jo-pjesëmarrësve, Komuna e Gjilanit

09
Pjesa e përqindjes midis jo-pjesëmarrësve, Komuna e Ferizajit

10
Pjesa e përqindjes midis jo-pjesëmarrësve, Komuna e Obiliqit

11
Pjesa e përqindjes midis jo-pjesëmarrësve, Komuna e Klinës

12
Pjesa e përqindjes midis jo-pjesëmarrësve, Komuna e Fushë Kosovës

13
Pjesa e përqindjes midis jo-pjesëmarrësve, Komuna e Vushtrrisë

14
Pjesa e përqindjes midis jo-pjesëmarrësve, Komuna e Kamenicës

15
Pjesa e përqindjes midis jo-pjesëmarrësve, sipas madhësisë së Komunave

16
Pjesa e përqindjes midis jo-pjesëmarrësve, sipas nivelit kombëtar

Definicionet

ARSIMI NË DISTANCË

Edukimi formal i bazuar në institucion, ku grupet e të mësuarit janë të ndara, dhe ku përdoren sisteme interaktive telekomunikuese për të lidhur nxënësit, burimet dhe instruktorët njohet si arsim ne distance ''

HENDEKU DIGJITAL

Hendeku midis individëve, familjeve, bizneseve dhe zonave gjeografike në nivele të ndryshme socio-ekonomike në lidhje me mundësitë e tyre për të hyrë në TIK dhe për përdorim të internetit për një shumëllojshmëri të gjerë të aktiviteteve.

HENDEKU DIGJITAL GJINOR

Llogarit hendekun si ndryshim mes djemve dhe vajzave te perfshire ne digjitalizim, e paraqitur si përqindje e vajzave te perfshira ne digjitalizim.

HENDEKU GJINOR

Pabarazia relative në mes njerëzve të gjinive të ndryshme reflektohet në një shumëllojshmëri sektorësh në shumë shoqëri.

KOMPETENCA DIGJITALE

Kapaciteti për të marrë, përpunuar dhe komunikuar informacion digjital, i cili është i ndikuar nga sfondi socio-kulturor, përfshirë mjedisin e shtëpisë, kapitalin kulturor dhe orientimin akademik; faktorë të tillë shpjegojnë ndryshimet në kompetencën digjitale në mes nxënësve.

PABARAZIA DIGJITALE

Pabarazitë në njohuritë dhe aftësinë e përdorimit të teknologjisë digjitale dhe të informacionit në mes individëve me demografi të ndryshme, prejardhje socio-ekonomike dhe përvojë dhe kompetenca të teknologjisë digjitale dhe të informacionit.

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Ndërprerja e mësimit sjell pasoja serioze, si në nivel personal ashtu edhe në atë shoqëror. Në situata specifike siç janë krizat e ndryshme dhe pandemitë, sistemet arsimore e kanë pothuajse të pamundur të sigurojnë vazhdimësi dhe gjithëpërfshirje në procesin edukativ për të gjithë. Historia ka treguar se gjatë krizave, arsimi është një nga sektorët publik ndër më të prekurit. Përderisa disa vende kanë burime të mjaftueshme për të siguruar që fëmijët të vijojnë mësimin gjatë këtyre kohërave, vendet e tjera ballafaqohen mesfida për të siguruar arsim gjithëpërfshirës dhe cilësor për të gjithë nxënësit. Si rezultat, krizat globale shpesh përcillen edhe me krijimin e hendeqeve dhe dallimevegjinore, duke shkaktuar që vendet me të ardhura të mesme dhe të ulëta të mos përparojnë drejt arritjes së barazisë gjinore në arsim.

Pandemia Covid-19 ka shtyrë shumë vende të kërkojnë zgjidhje të ndryshme për të siguruar arsim cilësor në distancë për të gjithë nxënësit. Disa vende kanë përshtatur përdorimin e medieve tradicionale, të tilla si TV dhe radio, ndërsa vende të tjera kanë përdorur metoda më bashkëkohore të ndërtuara kryesisht në platforma online. Llojllojshmëria e zgjidhjeve të përdorura gjatë kësaj kohe ka theksuar ndarjen në qasje digjitale në bazë të statusit shoqëror dhe gjinisë. Derisa disa vende kanë qenë në gjendje t'i adaptohen këtyre ndryshimeve në sistemin edukativ, duke përdorur teknologji të sofistikuar, në vendet e tjera fëmijët kanë përjetuar pasojat e një hendeku masiv digjital.

Të dhënat tona dytësore tregojnë se në nivel global, ndarja digjitale ka baza gjinore, pasi që djemtë kanë qasje më të mirë në arsimin në distancë. Mirëpo, analizat e të dhënave tona primare nxjerrin se në nivel kombëtar, ndarja gjinore është më pak e theksuar. Në Kosovë, shumë fëmijë, përfshirë edhe djem edhe vajza, kanë humbur mësimin gjatë shpërthimit të pandemisë. Ndarja digjitale në baza gjinore në nivel kombëtar varion nga komuna dhe niveli i shkollimit.

Gjetjet kryesore:

- Gjatë pandemisë, nga muaji mars deri në qershor 2020, rreth 5 për qind ose 8,414 nga 180,469 nxënës të regjistruar në shkollat fillore dhe të mesme në 12 komuna në Kosovë nuk kanë vijuar mësimin online.
- Përqindja e nxënësve të cilët nuk vijuan mësimin online gjatë pandemisë ishte dukshëm më i lartë në komunat e vogla se sa në komunat e mëdha.
- Ndarja digjitale gjinore në komunat e mëdha ishte rreth 1 pikë përqindje në favor të djemve. Që do të thotë që pjesëmarrja e djemve në mësimin online ishte një përqind më e vogël se pjesëmarrja e vajzave.
- Komunat e vogla (Obiliqi, Klina, Fushe Kosova, Vushtrria dhe Kamenica) raportuan një ndarje digjitale gjinore gati të papërfillshme me 0.13 përqind në disfavor të djemve.
- Brenda nxënësve jo pjesëmarrës të shkollave të mesme në komunat e vogla, ekzistonte një hendek gjinor afërsisht prej 3 përqind diferencë në disfavor për vajzat.

Së fundmi, gjetjet shpërfaqin nevojën për të forcuar qëndrueshmërinë e sistemit arsimor përmes shfrytëzimit të mundësive digjitale për të sjellë zgjidhje të aplikueshme për të gjithë. Sistemi ynë i arsimit duhet po ashtu të prioretizojë gjithëpërfshijen dhe të ndërmarrë masa për te siguruar barazi në arsim. Kjo përfshin barazinë gjinore si dhe siguron që nxënësit nga radhët e komuniteteve të cenueshme mbështeten në format e nevojshme për të siguruar rikthimin e tyre në shkolla. Në fund, hisedarët apo palët e përfshira në ngritje të sistemit të arsimit, duhet të punojnë drejt sigurimit të qasjes së barabartë në arsimin në distancë dhe zhvillimit të masave politike që mundësojnë krijimin e një mjedisi adekuat të mësimit në distancë.

HYRJE

Edhe para pandemisë COVID-19, bota po përballej me vështirësi në sigurimin e arsimit si një e drejtë themelore e njeriut për të gjithë fëmijët (UN 2020). Pandemia masivizoi problemet në arsimin global duke nxjerrë rreth "1.53 miliardë nxënës jashtë shkollave, kështu duke prekur 87.6 përqind të nxënësve në të gjithë botën (ECW, 2020). Sipas Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës së Kosovës (MASH, 2020), në fillim të izolimit, në mars 2020, rreth 32 mijë nxënës parauniversitarë, ose afërsisht 11 përqind, nuk kishin fare qasje në mësimin në distancë. Katërmbëdhjetëmijë të tjerë u raportuan se kishin humbur mësimin kryesisht për shkak të mungesës së aseteve digjitale ose infrastrukturës së internetit.

Me mbylljen graduale të shkollave në mbarë botën, shumë vende shpejt kaluan nga mësimi tradicional në mësimin në distancë. Sidoqoftë, për shkak të mungesës së qasjes në internet, pajisjeve dhe ndërveprimit të drejtpërdrejtë nxënës-mësues, ishte veçanërisht sfiduese për shumë qeveri që të siguronin vazhdimin e mësimit dhe parandalonin braktisjen e shkollave për të gjithë nxënësit (UNESCO, 2020). Kjo situatë më tej ka shpërfaqur se sistemet e arsimit në shumicën e vendeve janë kryesisht të papërgatitura që në raste krizash të sigurojnë vazhdimësi të mësimit gjithëpërfshirës.

COVID-19, po ashtu, ka vënë një fokus në pabarazitë gjinore në arsim. Nga një raport iUNESCO-s i nxjerrë në gusht 2020, del se "në 46 vende, 735 milionë nxënës - përfshirë 356 milionë vajza - nuk dihet se kur do t'i kthehen përsëri mësimit" (UN, 2020), duke përfshirë edhe mësimin në distancë. Sa më shumë që nxënësit mbesin jashtë shkollave, aq më shumë ka gjasa që ata të braktisin shkollën. Kjo për shkak të një numri të madh faktorësh, duke përfshirë: a) kufizimet financiare dhe nevojën për punësim, b) punët e shtëpisë, c) kujdesin për fëmijët, veçanërisht kur prindërit janë të sëmurë ose kanë ndërruar jetë, ç) martesat e hershme dhe të imponuara si dhe/ose shtatzënitë e hershme apo të pa planifikuara" (UN, 2020).

Barazia gjinore në arsim nuk do të thotë thjesht qasje në arsim, por fuqizim i barabartë gjatë gjithë shkollimit (UNESCO, 2020). Edhe pse kemi parë përmirësim në regjistrimin e vajzave në shkollë gjatë dy dekadave të fundit, kjo rrezikon të ketë regres për shkak të mbylljes së shkollave gjatë pandemisë COVID-19. Përderisa shkollat janë të mbyllura, "normat gjinore mund t'i përjashtojnë vajzat nga infrastruktura dhe platformat digjitale të nevojshme për mësimin në distancë"(UNICEF, 2020).

Që nga fillimi i pandemisë, vendet kanë zbatuar programe mësimore online dhe në distancë për të mbajtur fëmijët e angazhuar në mësimnxënien afër. Sidoqoftë, shumë fëmijëve u është pamundësuar mësimi në distancë për shkak të mungesës së pajisjeve teknologjike ose qasjes në internet (UNICEF, 2020). Në të gjithë botën, vajzat kanë dy herë më shumë gjasa të braktisin shkollën (ECW, 2020), dhe vazhdimi i mbylljes së shkollave do të ngadalësojë përparimin që vajzat kanë bërë në arsim gjatë dy dekadave të fundit, veçanërisht në pjesëmarrje (UNICEF, 2020). Prandaj, qëllimi i këtij studimi është shpalosja e ndarjes digjitale gjinore në mes të nxënësve të Kosovës të cilët nuk e vazhduan mësimin në distancë gjatë pandemisë COVID-19.

PËRMBLEDHJE E HULUMTIMIT

Pyetja më e shpeshtë e ditëve të sotme është nëse mësimi në distancë apo online është po aq efektiv sa mësimi tradicional dhe nëse mësimi në distancë do të vazhdojë edhe pas pandemisë.

Të dhënat flasin se për nxënësit që kanë qasje në teknologji, të mësuarit online mund të jetë më efektiv. Kjo për shkak se nxënësit janë në gjendje të "mësojnë sipas ritmit të tyre duke lexuar sipërfaqësisht, duke rilexuar apo duke kaluar kohë me konceptet që ata zgjedhin vetë" (Gutierres, 2016). Mirëpo, për shkak të mungesës së qasjes në teknologji - e njohur gjithashtu si ndarja digjitale - humbja e mësimit e paraqitur gjatë COVID-19, mund t'i mbajë disa fëmijë në disavantazh krahas moshatarëve të tyre.

Bazuar në të dhënat nga shpërthimi i virusittë Ebolës, Fondacioni Malala vlerësoi ndikimin e mundshëm të mbylljes së shkollave në braktisjen e shkollave nga vajzat në vendet me të ardhura të ulëta. Studimi vlerësoi se rreth 10 milionë vajza të nivelit të mesëm shkollor mund të mbesin jashtë shkollave pas krizës COVID-19 (Malala Fund, 2020). Rreziku i moskthimit në shkollë pas pandemisë është i dukshëm si për vajzat ashtu edhe për djemtë, me një përqindje më të lartë të vajzave që kanë më shumë gjasa të preken në nivelin parafillor dhe të mesëm të lartë. Ndërsa një përqindje më e lartë e djemve që janë në një rrezik më të madh të moskthimit në shkolla, kryesisht në nivelin fillor, të mesëm e të ulët, si dhe universitar (UNESCO, 2020).

Sipas të dhënave nga Banka Botërore, dallimet gjinore në përfundimin e shkollimit fillor janë më të theksuara në vendet me të ardhura të ulëta. Sipas këtyre të dhënave, në vendet me të ardhura të ulëta, deri në 2018, përfundimi i nivelit primar për djemtë arriti 67 përqind, ndërsa për vajzat në 62.7 përqind. Në vitet e 90-ta, dallimi gjinor ishte për rreth 35 përqind, me 39.6 milionë djem dhe 52.1milionë vajza të mbetura jashtë nivelit të arsimit fillor në të gjithë botën. Në fillim, në vitet e 2000-ta, 42 milionë djem dhe 57.1 milionë vajza ishin të papërfshirë në shkolla. Në vitin 2018, ky dallim u ngushtua me një diferencë prej 5 milionë ose 26.7 milionë djem dhe 31.4 milionë vajza jashtë arsimit fillor në të gjithë botën. Një situatë e ngjashme vazhdon në arsimin e mesëm të ulët, ndërsa dallimi gjinor në më shumë në arsimin e lartë (Të dhënat e Bankës Botërore, 2020).

Ndërsa në nivel kombëtar, deri në vitin 2012, në Kosovë, vetëm gjysma e popullsisë mbi 15 vjeç kishte të përfunduar shkollimin nëntë vjeçar. Përfshirja e vajzave ishte shumë më e ulët se ajo e djemve, 62 përqind të vajzave/grave dhe 37 përqind të djemve/burrave kishin vetëm arsimin bazë, ndërsa 6 përqind e vajzave/grave dhe 12 përqind e djemve/burrave kishin diploma universitare (Banka Botërore, 2012). Sidoqoftë, ky dallim gjinor është ngushtuar gjatë shtatë viteve të fundit. Bazuar në të dhënat eagjencisë të statistikave 2018/19, 48 përqind e vajzave dhe 52 përqind e djemve ndoqën arsimin parafillor. Ekziston një strukturë e ngjashme gjinore në arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, me 49 përqind të vajzave dhe 51 përqind të djemve të pranishëm (ASK, 2019).

01



Prandaj, përqindja e llogaritur e pjesëmarrjes së djemve dhe vajzave në institucionet parauniversitare për vitin 2018/19 tregon se: pjesëmarrja e djemve është 1.13 përqind më e lartë se pjesëmarrja e vajzave në parashkollor, kurse pjesëmarrja e djemve dominon për 1.08 përqind në arsimin parafillor, dhe 1.04 përqind në arsimin fillor dhe të mesëm të lartë. Në përgjithësi, ekziston një dallim i vogël në mes pjesëmarrjes së vajzave dhe djemve në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar.

Nëse shikojmë përqindjen e nxënësve (djem dhe vajza) në institucionet arsimore, sipas nivelit dhe komunës, mund të shohim se numri i përgjithshëm i fëmijëve në kopshte (0 deri në <5 vjeç) në shtatë komuna të mëdha në Kosovë, në vitin akademik 2019/20, është 4,164. Ky numër përfshin 2,206 djem dhe 1,958 vajza. Me 11,244 djem dhe 10,416 vajza, numri i fëmijëve që ndjekin arsimin parafillor (5-6 vjeç) është dhjetë herë më i lartë se ai i kopshteve. Kurse në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, ka 118,085djem dhe 111,253 vajza.

Është e qartë se sikurse në gjithë botën ashtu edhe në nivel kombëtar, ekzistojnë dallime gjinore në arsimim, duke vendosur vajzat në rend të dytë. Por nga gjithë nxënësit që vijojnë shkollën, hulumtimet tregojnë se vajzat shpesh prijnë në mësimnxënie, përkatësisht në nivelet fillore dhe ato të mesme. Vajzat gjithashtu kanë tendencë të aspirojnë drejt arsimit të lartë, të marrin lëndë më të avancuara dhe tëpërfshihen më shumë në aktivitete jashtë shkollore. Sipas të dhënave, djemtë zakonisht kanë prirë në matematikë. Mirëpo, ky dallim po zvogëlohet duke shkuar drejt zhdukjes. Djemtë po mbesin gjithnjë e më mbrapa, duke krijuar kështu një dallim gjinor në mësimnxënie të paraprirë nga vajzat (Melnick, R. Shep. 2018).

Edhe pse në shumë vende të botës vajzat kanë arritur nivel të barabartë me djemtë në aspekt të vijueshmërisë së arsimit fillor dhe atë të mesëm, tani në shumë më tepër vende rrezikohet që të mos arrihet kjo barazi për shkak të situatës së krijuar nga mësimi në distancë. Të dhënat nga vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme tregojnë se prindërit u japin vajzave qasje në teknologjinë digjitale në një moshë më të rritur krahasuar me djemtëdhe se qasja e tyre është "më e kufizuar ose e mbikëqyrur" (Livingstone, S. et al., 2017). Ndërsa botërisht, burrat kanë më shumë qasje në internet, dhe pandemia COVID-19 ka zgjeruar edhe më tej këtë ndarje digjitale gjinore, veçanërisht në vendet në zhvillim.

Si pasojë, nuk është për t'u habitur që vajzat kanë 25 përqind më pak gjasa se djemtë të dinë se si të përdorin teknologjinë për qëllime bazike siç është mësimi në distancë (UNESCO, 2020). Me fjalë të tjera, në kontekstin e mësimit në distancë, përdorimi i teknologjisë mund të thellojë më tej hendekun gjinor. Por teknologjia mund të jetë edhe një mundësi për të mbyllur këtë dallim gjinor duke ndërtuar aftësive digjitale për dy gjinitë dhe duke siguruar që të gjithë nxënësit të kenë aftësitë e nevojshme për të qëndruar të sigurt në internet dhe për të ndjekur mësimin në distancë (UNESCO, 2020).

02



METODOLOGJIA

Ky seksion jep një përshkrim të përgjithshëm të qasjes metodologjike të këtij studimi. Për të analizuar dallimin apo ndarjen gjinore në qasjen në mësimin në distancë në Kosovë, së pari identifikuam numrin e përgjithshëm të fëmijëve të cilët nuk ndoqën mësimin në distancë gjatë fazës së parë të tranzicionit në mars 2020. Informacioni u mblodh duke mobilizuar drejtoritë e arsimit të komunave në Kosovë për të ndarë të dhëna mbi numrin e fëmijëve që nuk mund të ndiqnin mësimin në distancë ose mësimin për shkak të faktorëve të ndryshëm, siç është mungesa e pajisjeve digjitale ose faktorëve të tjerë socio-ekonomikë.

Me kusht që studimi të nxjerrë të dhëna reprezentative, mostra e përgjithshme ka përfshirë shtatë komunat më të mëdha, si dhe disa komuna të vogla. Në total, 18 komuna (7 të mëdha dhe 11 të vogla) u kontaktuan për studimin. Nga komunat e kontaktuara, 12 (7 të mëdha dhe 5 të vogla) prej tyre i janë përgjigjur kërkesës sonë. Kalkulimet kanë nxjerrë se mostra jonë është e mjaftueshme për të gjeneruar rezultate përfaqësuese në 99 përqind nivel të besimit dhe 1 për qind margjinë të gabimit.

Përkatësisht, kategoria e pare përfshin të dhënat që vijnë nga komunat e mëdha, të tilla si: Prishtina, Prizreni, Peja, Gjilani, Mitrovica, Gjakova dhe Ferizaji. Kategoria e dytë përfshin të dhënat që vijnë nga komunat më të vogla, të tilla si: Fushë-Kosova, Vushtrria, Obiliqi, Kamenica dhe Klina. Nëntë nga 12 komunat ndanë informacion të plotë sipas kërkesës sonë; ndërsa tri komuna ndanë informacion të kufizuar. Gjashtë nga 18 komunat e kontaktuara nuk iu përgjigjën kërkesës tonë për të dhënat mbi numrin e mos vijueshmërisë së mësimit në distancë.

TABELA 1. Numri i përgjithshëm i nxënësve të regjistruar për vitin akademik 2019/2020.

2019/2020	Primare			Sekondare			Totali		
Komunat									
Komunat e Mëdha	M	F	Total	M	F	Total	M	F	Total
Prishtinë	15300	14540	29840	4904	5096	10000	20204	19636	39840
Prizren	10862	10182	21044	3566	3207	6773	14428	13389	27817
Pejë	6371	5986	12357	2120	2113	4233	8491	8099	16590
Gjakovë	6019	5366	11385	2181	2061	4242	8200	7427	15627
Mitrovicë	5352	5261	10613	1938	2201	4139	7290	7462	14752
Gjilan	5553	5326	10879	2311	2367	4678	7864	7693	15557
Ferizaj	8006	7816	15822	3061	3159	6220	11067	10975	22042
Komunat e Vogla									
Obiliq	1567	1514	3081	380	353	733	1947	1867	3814
Fushë Kosovë	3624	3346	6970	755	809	1564	4379	4155	8534
Klinë	2771	2730	5501	773	789	1562	3544	3519	7063
Kamenicë	1490	1447	2937	593	480	1073	2083	1927	4010
Vushtri	5105	4687	9792	1489	1326	2815	6594	6013	12607
Total	72020	68201	140221	24071	23961	48032	96091	92162	188253

Burimi: ASK, 2020

Për më tepër, ekipi ka shqyrtuar gjithashtu raporte dhe analiza krahasuese të të dhënave sasiore si një kombinim i teknikave kërkimore për të ofruar rezultatet më të plota të hulumtimit. Nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, numri i nxënësve sipas gjinisë në arsimin publik në komunat përkatëse për vitin akademik 2019/2020, është 92,162 vajza dhe 96,091 djem. Numri i përgjithshëm i nxënësve në arsimin publik parauniversitar numëron 329,589 në të 37 komunat në Kosovë (ASK).

Ndërkaq analizat e të dhënave primare të këtij studimi ndahen në tre seksione. Seksioni i parë paraqet rezultatet për komuna ose rezultatet lokale; seksioni i dytë paraqet të dhënat dhe analizat bazuar në kategorinë e komunave; dhe seksioni i tretë dhe i fundit paraqet rezultatet e përgjithshme ose kombëtare.

REZULTATET LOKALE

PRISHTINË

Gjatë fazës së parë të pandemisë në Kosovë, gjithsej 1722 nxënës në Prishtinë nuk vijuan mësimin online. Ky numër përfaqëson 13.7 përqind të nxënësve të regjistruar në Komunën e Prishtinës, si dhe shënon përqindjen më të lartë nga të gjitha qytetet.

Përqindja e nxënësve në nivelin e mesëm të cilët nuk vijuan mësimin online, ishte më e lartë se përqindja e nxënësve nga niveli fillor. Më konkretisht, rreth 6.45 përqind e nxënësve të regjistruar në shkollat fillore të Komunës së Prishtinës nuk vijuan mësimin online. Kurse numri i nxënësve të shkollave të mesme në Komunën e Prishtinës, të cilët nuk vijuan mësimin gjatë pandemisë, arriti në 7.96 përqind.



Sa i përket gjinisë, në Komunën e Prishtinës rreth 1376 ose 7.0 përqind të vajzave dhe 1346 ose 6.7 përqind të djemve të regjistruar nuk vijuan mësimin online. Sidoqoftë, ky dallim gjinor ndryshon varësisht nga niveli i shkollimit. Për shembull, nga shkollat fillore rreth 7.24 përqind e djemve dhe 6.71 përqind e vajzave nuk vijuan mësimin online, ndërsa nga shkollat e mesme 8.08 përqind e djemve dhe 7.85 përqind e vajzave nuk vijuan mësimin online gjatë pandemisë. Kjo tregon se përderisapërqindja e përgjithshme e vajzave që nuk kanë ndjekur mësimin online ishte më e lartë se përqindja e djemve, rezultatet ndryshojnë në bazë të nivelit shkollor pasi që përqindja e djemve që nuk vijuan mësimin online në nivelin primar është më e lartë se ajo e vajzave. E njëjta gjë vlen për nivelin sekondar.

7.0% **6.7%**

03

Pjesa e përqindjes midis jo-pjesëmarrësve, Komuna e Prishtinës

REZULTATET LOKALE

PRIZREN

Në Prizren, numri i nxënësve që nuk vijuan mësimin online ishte dukshëm më i ulët. Komuna e Prizrenit raportoi se vetëm 2.2 përqind, ose 309 nxënës, nuk ishin përfshirë në mësimin online, duke u bërë kështu komuna e dytë me numrin më të ulët të nxënësve që nuk vijuan mësimin online.

Siç është raportuar, rreth 1.44 përqind e nxënësve të shkollës fillore dhe vetëm 0.10 përqind e nxënësve të shkollës së mesme në Prizren nuk vijuan mësimin online. Pra, numri i nxënësve të shkollave të mesme të raportuar nga Komuna e Prizrenit, të cilët nuk vijuan mësimin gjatë pandemisë ishte veçanërisht i ulët.



Në Prizren, numri i vajzave që nuk vijuan mësimin gjatë pandemisë ishte më i lartë se numri i djemve. Konkretisht, 205 vajza ose 1.53 përqind e vajzave dhe 104 djem ose 0.72 përqind e djemve të regjistruar në Komunën e Prizrenit nuk vijuan mësimin online. Dallimi gjinor mbetet ngjashëm edhe në bazë të nivelitshkollor. Për shembull, përqindja e vajzave të regjistruara në shkollat fillore në Prizren që nuk vijuan mësimin gjatë pandemisë ishte 1.95 përqind, ndërsa mospjesëmarrja e djemve ishte 0.95 përqind. Megjithatë, dallimi gjinor ishte më i vogël midis nxënësve të shkollës së mesme. Më konkretisht, rreth 0.03 përqind e djemve dhe 0.19 përqind e vajzave të regjistruara në shkollat e mesme të Prizrenit nuk e vazhduan mësimin online pas mbylljes së shkollave gjatë pandemisë.

1.5% **0.7%**

04

Pjesa e përqindjes midis jo-pjesëmarrësve, Komuna e Prizrenit

REZULTATET LOKALE

PEJË

Në Pejë, përqindja e nxënësve që nuk vijuan mësimin gjatë pandemisë ishte më e lartë se ajo e Prizrenit. Më konkretisht, 620 nxënës ose 7.3 përqind e numrit të përgjithshëm të regjistruar në Pejë nuk vijuan mësimin online.

Për më tepër, ekzistonte një dallim i vogël midis përqindjes së nxënësve të shkollës fillore dhe nxënësve të shkollave të mesme që nuk vijuanmësimin gjatë pandemisë, me ç'rast mos vijimi i mësimit nga nxënësit e shkollave të mesme ishte pak më i lartë. Për shembull, 3.71 përqind e nxënësve të shkollave fillore dhe 3.83 përqind e nxënësve të shkollave të mesme të regjistruar në Komunën e Pejës nuk morën pjesë në mësimin online.



Dallimi gjinor në qasjen në mësimin online në Komunën e Pejës ishte dukshëm më i lartë, me djemtë që prijnë dukshëm në mospjesëmarrje. Rreth 187 ose 2.31 përqind e vajzave dhe 433 ose 5.10 përqind e djemve, nga Komuna e Pejës, nuk vijuan mësimin online. Përqindja e vijimit të nxënësve në mes nivelesh gjithashtu dallon në bazë të gjinisë. Për shembull, në nivelin fillor, kishte një dallim gjinor prej 1.92 përqind, me rreth 2.72 përqind të vajzave dhe 4.63 përqind të djemve që nuk vijuan mësimin gjatë pandemisë. Dallimi gjinor është dukshëm më i lartë në arsimin e mesëm. Më konkretisht, në shkollat e mesme të Komunës së Pejës, dallimi gjinor i jo pjesëmarrësve ishte 5.37 përqind, me 6.51 përqind të djemve dhe 1.14 përqind të vajzave që ndërprenë arsimimin e tyre gjatë pandemisë.

05

Pjesa e përqindjes midis jo-pjesëmarrësve, Komuna e Pejës

REZULTATET LOKALE

GJAKOVË

Pas kryeqytetit, Gjakova kishte numrin më të lartë të raportuar të nxënësve që nuk mund të vijonin mësimin online. Rreth 711 ose 9.6 përqind e nxënësve të regjistruar nuk vijuan mësimin online.

Përqindja e nxënësve të shkollës së mesme të regjistruar të cilët nuk vijuan mësimin online gjatë pandemisë ishte më e lartë se ajo e nxënësve të shkollës fillore. Saktësisht, 4.47 përqind e nxënësve të shkollës fillore dhe 6.18 përqind e nxënësve të shkollës së mesme, të regjistruar në Komunën e Gjakovës, nuk e ndoqën mësimin online gjatë pandemisë.



Ndarja gjinore në Komunën e Gjakovës ishte e ngjashme me atë të Pejës. Më konkretisht, rreth 242 ose 3.2 përqind e vajzave dhe 529 ose 6.4 përqind e djemve në Komunën e Gjakovës nuk vijuan mësimin online. Rezultatet ndryshojnë dukshëm në bazë të gjinisë dhe nivelit të shkollës. Në shkollat fillore të Gjakovës, diferenca gjinore e jo pjesëmarrësve ishte 1.83 përqind në disfavor të djemve, me 5.33 përqind të djemve dhe 3.50 përqind të vajzave që nuk vijuan mësimin online. Kurse në shkollat e mesme diferenca gjinore arriti në 7.02 përqind, ku 9.64 përqind të djemve dhe 2.62 përqindja e vajzave nuk vijuan mësimin online.

06

Pjesa e përqindjes midis jo-pjesëmarrësve, Komuna e Gjakovës

REZULTATET LOKALE

MITROVICË

Me 648 ose 8.7 përqind të nxënësve që nuk morën pjesë në mësimin online, Komuna e Mitrovicës është në mesin e tri qyteteve kryesore me numrin më të lartë të nxënësve që nuk vijuan mësimin gjatë pandemisë.

Të dhënat ndryshojnë në bazë të nivelit të shkollës. Për shembull, përderisa përqindja e nxënësve të shkollës fillore që nuk vijuan mësimin online arriti në 5.46 përqind, përqindja e nxënësve të shkollës së mesme të raportuar për mos vijim ishte 1.64 përqind.

Dallimi gjinor, megjithatë, vërehet kryesisht me djemtë që prijnë në mospjesëmarrje. Më konkretisht, rreth 315 ose 4.2 përqind e vajzave dhe 333 ose 4.5 përqind e djemve të regjistruar në Komunën e Mitrovicës nuk vijuan mësimin online. Për më tepër, dallimi gjinor sipas nivelit shkollor nuk kishte i konsiderueshëm. Dallimi gjinor mbi mos vijimin në shkollat fillore ishte 0.29 përqind, me specifikisht 5.61 përqind të djemve dhe 5.32 përqind të vajzave të lënë jashtë procesit mësimor, ndërsa dallimi gjinor mbi mos vijimin në shkollat e mesme ishte 0.11 përqind, më specifikisht 1.7 përqind të djemve dhe 1.59 përqind e vajzave mospjesëmarrës në procesin mësimor gjatë pandemisë.



3.2%

6.4%

07

Pjesa e përqindjes midis jo-pjesëmarrësve, Komuna e Mitrovicës

REZULTATET LOKALE

GJILAN

Në Komunën e Gjilanit, përqindja e nxënësve që mbetën jashtë procesit mësimor gjatë pandemisë ishte e ngjashme me atë të Komunës së Mitrovicës, me 657 nxënës ose 8.4 përqind e nxënësve të regjistruar gjithsej që nuk vijuan mësimin online.

Të dhënat dallojnësipas nivelit të shkollës. Rreth 5.27 përqind e nxënësve të regjistruar në shkollat fillore të Komunës së Gjilanit dhe 1.10 përqind e nxënësve të shkollave të mesme nuk vijuan mësimin online duke shënuar një dallim prej 4.17 përqind mes jo pjesëmarrësve nga Komuna e Gjilanit sipas nivelit të shkollës.



Sidoqoftë, dallimi gjinor në mos vijimin e mësimit online nga nxënësit e Komunës së Gjilanit është më se i dallueshëm. Konkretisht, rreth 200 ose 2.6 përqind e vajzave dhe 457 ose 5.8 përqind e djemve në Komunën e Gjilanit nuk vijuan mësimin gjatë pandemisë. Shifrat dallojnë dukshëm edhe në bazë të nivelit shkollor, ku në nivelin fillor djemtë prijnë për mospjesëmarrje. Konkretisht, dallimi gjinor për mos vijimin e mësimin online në shkollat fillore arriti 3.9 përqind \ me 7.17 përqind të djemve dhe 3.27 përqind të vajzave të regjistruar si mospjesëmarrës. Dallimi gjinor ishte më i ulët në mesin e nxënësve të shkollës së mesme, me 2.55 përqind të djemve dhe 1.10 përqind të vajzave të regjistruara që nuk vijuan mësimin online gjatë pandemisë.

08

Pjesa e përqindjes midis jo-pjesëmarrësve, Komuna e Gjilanit

REZULTATET LOKALE

FERIZAJ

Komuna e Ferizajt raportoi vetëm numrin e nxënësve të shkollave fillore që nuk vijuan mësimin online gjatë mbylljes së shkollave për shkak të pandemisë. Numri i përgjithshëm i rasteve të raportuara nga shkollat fillore ishte 416.

Ashtu si në Komunën e Gjilanit, përqindja e djemve që nuk e vijuan mësimin online ishte më e lartë se ajo e vajzave, por ndryshimi nuk ishte aq i dukshëm. Më konkretisht, rreth 1.7 përqind ose 188 nga vajzat e regjistruara dhe 2.0 përqind ose 228 nga djemtë e regjistruar gjithsej në shkollat e Komunës së Ferizajt nuk vijuan mësimin online.



1.7%

2.0%

09

Pjesa e përqindjes midis jo-pjesëmarrësve, Komuna e Ferizajit

REZULTATET LOKALE

OBILIQ

Në Komunën e Obiliqit, 244 ose 6.4 përqind e nxënësve nuk vijuan mësimin online gjatë pandemisë.

Me 2 përqind dallim, përqindja e nxënësve të shkollës fillore, të cilët nuk vijuan mësimin online, ishte më e lartë se përqindja e nxënësve të shkollave të mesme. Konkretisht, 6.78 përqind e nxënësve të regjistruar në shkolla fillore dhe 4.77 përqind nxënës të regjistruar të shkolla të mesme në Komunën e Obiliqit nuk e vazhduan mësimin online pas mbylljes së shkollave.

Në raportimin e Obiliqit për pjesëmarrjen në mësim online, kishte një dallim të vogël gjinor. Më konkretisht, 117 ose 6.27 përqind të vajzave të regjistruara dhe 127 ose 6.52 përqind të djemve të regjistruar nuk e vijuan mësimin online. Ngjashëm, me një ndryshim prej 0.02 përqind brenda nxënësve të shkollës fillore dhe 0.07 përqind brenda nxënësve të shkollës së mesme, mund të konsiderohet se nuk ka pothuajse aspak dallime gjinore sipas nivelit të shkollës.



6.3%

6.5%

10

Pjesa e përqindjes midis jo-pjesëmarrësve, Komuna e Obiliqit

REZULTATET LOKALE

KLINË



Në Komunën e Klinës rreth 448 nxënës ose 6.3 përqind e nxënësve të regjistruar u raportuan që nuk kishin vijuar mësimin online pas mbylljes së shkollave.

Rreth 7.45 përqind e nxënësve nga shkollat fillore dhe 2.43 përqind e nxënësve nga shkollat e mesme në Komunën e Klinës u raportuam se nuk kanë marrë pjesë në mësim online, duke nxjerrë një dallim të dukshëm prej 5.02 përqind mes nxënësve jo vijues sipas nivelit të shkollës.

Sidoqoftë, kjo shpërfaq dallimin gjinor prej 1.2 përqind brenda grupit të nxënësve që nuk vijuan mësimin në distancë. Rreth 201 ose 5.7 përqind e vajzave dhe 247 ose 6.9 përqind e djemve të regjistruar në shkollat e Komunës së Klinës nuk vijuan mësimin online. Nga të dhënat vërehet një dallim i vogël gjinor mes jo pjesëmarrësve në bazë të nivelit të shkollës. Në shkollat fillore, rreth 8.5 përqind e djemve dhe 6.85 përqind e vajzave nuk morën pjesë në mësimin online duke quar dallimin gjinor në 1.65 përqind. Në shkollat e mesme, rreth 3.10 përqind e djemve dhe 1.77 përqind e vajzave nuk morën pjesë në mësimin online, duke quar dallimin gjinor në 1.33 përqind.

6.9%

8.5%

11

Pjesa e përqindjes midis jo-pjesëmarrësve, Komuna e Klinës

REZULTATET LOKALE

FUSHË KOSOVË

Komuna e Fushë-Kosovës raportoi se 516 nxënës, që përfaqësojnë 6.0 përqind të nxënësve të regjistruar, nuk vijuan mësimin online.

Sidoqoftë, këta numraparaqesin vetëm të dhënat e nxjerra nga shkollat fillore, që do të thotë se komuna nuk raportoi numrin e nxënësve të shkollave të mesme të cilët nuk vijuan mësimin online gjatë pandemisë.

Përqindja e vajzave që nuk kanë vijuar mësimin online ishte pak më e lartë se ajo e djemve. Konkretisht, 258 ose 7.7 përqind e vajzave dhe 258 ose 7.1 përqind e djemve të regjistruar në shkollat e komunës së Fushë-Kosovës nuk e vijuan mësimin online.



7.7%

7.1%

12

Pjesa e përqindjes midis jo-pjesëmarrësve, Komuna e Fushë Kosovës

REZULTATET LOKALE

VUSHTRRI

Numri i raportuar nga Komuna e Vushtrrisë për nxënësit që nuk vijuan mësimin online ishte 973 duke përbërë 7.7 përqind të gjithsej nxënësve të regjistruar.

Konkretisht, 8.16 përqind të nxënësve të shkollës fillore dhe 6.18 përqind të nxënësve të shkollës së mesme humbën qasjen në arsim me mbylljen e shkollave, duke krijuar një ndarje prej 1.98 përqind midis jo pjesëmarrësve nga shkollat fillore kundrejt atyre të mesme në Komunën e Vushtrrisë.

Po ashtu, shohim dallime gjinore brenda jo pjesëmarrësve nga Komuna e Vushtrrisë. Më konkretisht, përqindja e vajzave që nuk kanë vijuar mësimin online arriti në 8 përqind ose 375 vajza nga gjithsej të regjistruara. Përqindja e djemve ishte më e ulët, 7.3 përqind, ose 369 nga gjithsej djemtë e regjistruar në Komunën e Vushtrrisë. Brenda jo pjesëmarrësve të shkollave fillore, kishte një dallim gjinor prej 0.31përqind, më specifikisht 8.01 përqind të djemve dhe 8.32 përqind të vajzave nuk vijuan mësimin online pas mbylljes së shkollave. Ndërsa me 5.04 përqind të djemve dhe 7.47 përqind të vajzave të shkollës së mesme, nxjerrim një dallim gjinor prej 2.43 përqind midis jo pjesëmarrësve të shkollës së mesme.



8.0%

7.3%

13

Pjesa e përqindjes midis jo-pjesëmarrësve, Komuna e Vushtrrisë

REZULTATET LOKALE

KAMENICË

Komuna e Kamenicës raportoi se vetëm 90 nxënës nga shkollat shqiptare dhe ato serbe, nuk e vijuanmësimin online gjatë pandemisë COVID-19. Numri i raportuar i nxënësve përfaqëson 2.2 përqind të gjithsej nxënësve të regjistruar, përqindje e ngjashme me atë të Komunës së Prizrenit dhe Komunës së Ferizajt.

Me një dallim prej 0.65 përqind, përqindja e nxënësve të shkollës fillore që nuk morën pjesë në mësim online ishte më e lartë se përqindja e nxënësve të shkollës së mesme. Konkretisht, 2.42 përqind e nxënësve të shkollës fillore dhe 1.77 përqind e nxënësve të shkollës së mesme të regjistruar në Komunën e Kamenicës nuk vijuan mësimin online gjatë pandemisë.



Sa i përket ndjekjes së mësimit online, kemi një dallim gjinor prej 0.5 përqind në Komunën e Kamenicës. Më konkretisht, 2.0 përqind ose 38 vajza dhe 2.5 përqind ose 52 djem nga gjithsej nxënësit e regjistruar nuk ishin në gjendje të vijonin mësimin online pas mbylljes së shkollave. Hendeku gjinor në këtë komunë, megjithatë, ka një pamje tjetër kur analizohet sipas nivelit të shkollës. Në mënyrë të veçantë, hendeku gjinor brenda nxënësve të shkollës fillore disfavorizoi djemtë, ndërsa hendeku gjinor brenda nxënësve të shkollës së mesme disfavorizoi vajzat. Konkretisht, nga nxënësit e regjistruar në shkolla fillore , 2.89 përqind e djemve dhe 1.94 përqind e vajzave nuk vijuan mësimin online; ndërsa nga nxënësit e shkollës së mesme, 1.52 përqind e djemve dhe 2.08 përqind e vajzave nuk vijuan mësimin online.

2.0%

2.5%

14

Pjesa e përqindjes midis jo-pjesëmarrësve, Komuna e Kamenicës

REZULTATET SIPAS MADHËSISË SË KOMUNAVE

Seksioni i dytë i analizës paraqet grupimin e rezultateve sipas madhësisë së komunave. Kështu, kategoria e parë paraqet grupimin e të dhënave nga komunat e mëdha, të tilla si: Prishtina, Prizreni, Peja, Gjilani, Mitrovica, Gjakova dhe Ferizaj. Ndërsa në kategoria e dytë, paraqet grupimin e të dhënave nga komunat e vogla, të tilla si: Fushë-Kosova, Vushtrria, Obiliqi, Kamenica dhe Klina. Kur krahasojmë rezultatet midis këtyre dy kategorive, shohim se përqindja e nxënësve të cilët nuk vijuan mësimin gjatë pandemisë ishte dukshëm më e lartë në komunat e vogla sesa në komunat e mëdha.

KOMUNAT E MËDHA



3.8% 4.6%

KOMUNAT E VOGLA



5.6% 7.1%

15

Pjesa e përqindjes midis jo-pjesëmarrësve, sipas madhësisë së Komunave

KOMUNAT E MËDHA

Komunat e mëdha raportuan një total prej rreth 4.21 përqind të nxënësve të regjistruar të cilët nuk vijuan mësimin gjatë pandemisë. Sa i përket gjinisë, përqindja e djemve që nuk vijuan mësimin ishte më e lartë se ajo e vajzave. Konkretisht, 4.61 përqind e djemve dhe 3.79 përqind e vajzave të regjistruar në komunat e mëdha nuk vijuan mësimin online gjatë pandemisë. Prandaj, dallimi apo ndarja gjinore në komunat e mëdha rezultoi të jetë 0.82 përqind në disfavor të djemve.

Një e dhënë tjetër nga komunat e mëdha është se numri i nxënësve të shkollave të mesme që nuk vijuan mësimin online ishte pak më i lartë se ai i nxënësve të shkollave fillore. Konkretisht, rreth 3.88 përqind e nxënësve të regjistruar në shkollat fillore dhe 4.05 përqind e nxënësve të regjistruar në shkollat e mesme të komunave të mëdha nuk morën pjesë në mësimin online. Në të dy nivelet shihet një dallim i vogël gjinor në disfavor të djemve. Për shembull, në shkollat fillore, rreth 4.52 përqind e djemve dhe 3.98 përqind e vajzave kurse në shkollat e mesme 4.91 përqind e djemve dhe 3.20 përqind e vajzave humbën qasjen në shkollim.

TABELA 2. Përqindja e nxënësve nga komunat e mëdha të cilët nuk vijuan mësimin online

2019/2020	Primare			Sekondare			Total		
Komunat e Mëdha	M	F	Total	M	F	Total	M	F	Total
	4.52%	3.98%	3.88%	4.91%	3.20%	4.05%	4.61%	3.79%	4.21%



KOMUNAT E VOGLA

Në komunat e vogla, përqindjet e jo pjesëmarrjeve ishin më të larta. Rreth 5.93 përqind e nxënësve të regjistruar në komunat e vogla nuk mund të vazhdonin mësimin gjatë pandemisë.

Ashtu si në kategorinë paraprake, përqindja e jo-vijueshmërisë së djemve ishte më e lartë se ajo e vajzave. Konkretisht, 7.06 përqind e djemve të regjistruar dhe 5.93 përqind e vajzave të regjistruara në komunat e vogla nuk e vazhduan mësimin online gjatë pandemisë. Prandaj, hendeku gjinor në komunat e vogla ishte 1.13 përqind në disfavor të djemve.

Në dallim nga komunat e mëdha, në komunat e vogla, numri i nxënësve të shkollës fillore që nuk e vijuan mësimin online ishte më i lartë se ai i nxënësve të shkollës së mesme. Konkretisht, rreth 7.09 përqind e nxënësve të shkollave fillore dhe 4.30 përqind e nxënësve të shkollave të mesme në komunat e vogla nuk vijuan mësimin online. Brenda nxënësve jo pjesëmarrës të shkollave fillore në komunat e vogla, ka një dallim të vogël gjinor me 0.13 përqind në disfavor të djemve Më detajisht, 7.15 përqind e djemve të shkollës fillore dhe 7.02 përqind e vajzave të shkollave fillore në shkollat fillore të komunave të vogla i kanë humbur mësimin gjatë pandemisë. Nga ana tjetër, në mesin e nxënësve jo pjesëmarrës të shkollave të mesme në komunat e vogla, del se hendeku gjinor është 2.67 përqind në disfavor të vajzave ku 2.05 përqind e djemve të shkollës së mesme dhe 4.72 përqind e vajzave të shkollës së mesme nuk kanë vijuar mësimin gjatë pandemisë.

TABELA 3. Përqindja e nxënësve nga komunat e vogla të cilët nuk vijuan mësimin online

2019/2020	Primare			Sekondare			Total		
Komunat e Vogla	M	F	Total	M	F	Total	M	F	Total
	7.15%	7.02%	7.09%	2.05%	4.72%	4.30%	7.06%	5.93%	5.93%

REZULTATET KOMBËTARE

KOSOVA

Të dhënat e mbledhura nga 12 komuna mbi mospjesëmarrjen e nxënësve në mësimin online gjatë pandemisë COVID-19, nxorën edhe të dhëna të përgjithshme për nivelin kombëtar. Nga 12 komuna të kontaktuara, dy prej tyre dërguan të dhëna jo të plota, duke mos raportuar numrin e nxënësve të shkollave të mesme që nuk morën pjesë në mësim online.

Nga rezultatet e disponueshme, të dhënat tregojnë se 4.83 përqind e nxënësve të regjistruar në shkollat fillore dhe 4.09 përqind e nxënësve të regjistruar në shkollat e mesme në komunat e kontaktuara ndërprenë mësimin me rastin e mbylljes së shkollave. Prandaj, duke zhvendosur mësimin apo klasat online, në të dy nivelet, atë fillor dhe të mesëm,një total prej 4.66 përqind e nxënësve të regjistruar u raportuan se kishin humbur të drejtën për arsimim.

Duke parë nga afër rezultatet e përgjithshme edhe sipas nivelit të shkollor, mund të shohim se ekziston një hendek gjinor prej 0.46 përqind brenda grupit të nxënësve të shkollës fillore. Rreth 5.05 përqind e djemve dhe 4.59 përqind e vajzave të regjistruara në shkollat fillore të komunave të anketuara u raportuan të mungojnë gjatë mësimit online. Sidoqoftë, me një ndryshim prej 1.33 përqind, hendeku gjinor ishte më i lartë brenda grupit të nxënësve të shkollave të mesme që nuk morën pjesë në mësimin online, por përsëri në disfavor të djemve. Konkretisht, 4.75 përqind e djemve dhe 3.42 përqind e vajzave të shkollës së mesme u raportuan se nuk vijuan mësimin online.

16

Pjesa e përqindjes midis jo-pjesëmarrësve, sipas nivelit kombëtar



5.5%

4.6%



KONKLUZIONI & REKOMANDIMET

Qëllimi i këtij studimi është të mas dallimin apo hendekun gjinor midis nxënësve në Kosovë të cilët nuk e vazhduan mësimin në distancë gjatë pandemisë COVID-19. Rezultatet e studimit janë nxjerrë nga të dhënat e paraqitura nga 7 komunat e mëdha dhe 5 komuna të vogla, që paraqesin një mostër përfaqësuese me një marzhë të vogël gabimi (<1).

Analiza e të dhënave tona tregon se komuna me përqindjen më të ulët të nxënësve jo pjesëmarrës gjatë mësimit online është Komuna e Prizrenit me një total prej 1.11 përqind të nxënësve të regjistruar të cilët nuk vijuan mësimin gjatë pandemisë. Nga ana tjetër, Komuna e Fushë-Kosovës me 7.40 përqind të nxënësve jo pjesëmarrës, është komuna me përqindjen më të lartë të nxënësve që kanë mbetur jashtë mësimit online. Sa i përket hendekut gjinor, dallimi më i madh ishte në mesin e nxënësve jo pjesëmarrës nga Komuna e Gjilanit, me një dallim prej 3.21 përqind në disfavor të djemve, ndërsa dallimi më i vogël ishte në mesin e nxënësve jo pjesëmarrës nga Komuna e Obiliqit, me 0.26 përqind diferencë në disfavor të djemve. Numri i nxënësve që nuk morën pjesë është më i lartë në komunat e vogla krahasuar me komunat e mëdha. Konkretisht, 4.21 përqind e nxënësve të regjistruar në komunat e mëdha dhe 5.93 përqind e nxënësve të regjistruar në komunat e vogla nuk vijuan mësimin online gjatë pandemisë. Ky dallim është më i dukshëm në bazë të nivelit shkollor. Po ashtu, hendeku gjinor del të jetë më i madh në komunat e vogla. Në komunat e mëdha, hendeku gjinor del se është 0.81 përqind në disfavor të djemve, ndërsa në komunat e vogla, 1.12 përqind, përsëri në disfavor të djemve.

Llogaritjet dhe analizat tona të të dhënave tregojnë se rreth 4.66 përqind e nxënësve të regjistruar nga komunat brenda studimit nuk vijuan mësimin online gjatë pandemisë COVID-19. Rezultatet tregojnë se ekziston një hendek gjinor prej 0.66 përqind mes jo pjesëmarrësve, në disfavor të djemve. Rreth 4.86 përqind e djemve të regjistruar dhe 4.20 përqind e vajzave të regjistruara në arsimin fillor dhe të mesëm në komunat e intervistuara u raportua se nuk kishin ndjekur mësimin online pas mbylljes së shkollave. Megjithatë, hendeku gjinor ndryshon sipas nivelit të shkollës. Për shembull, ekziston një hendek gjinor prej 0.46 përqind midis nxënësve jo pjesëmarrës të shkollës fillore dhe një hendek prej 1.33 përqind midis nxënësve të shkollës së mesme. Kjo mund të tregojë se hendeku më i madh gjinor në disfavor të djemve nuk është rezultat i diskriminimit, por rezultat i faktorëve të tjerë, siç janë motivimi dhe interesimi i nxënësve të shkollave të mesme.

Rezultatet e studimit tregojnë se hendeku gjinor brenda nxënësve jo pjesëmarrës në mësimin online nuk ishte domethënës. Numri i djemve që humbën mundësinë për të ndjekur mësimin online ishte fare pak më i lartë. Rezultatet gjithashtu tregojnë se dallimi në përqindjen e jo pjesëmarrësve nga komunat e mëdha kundrejt atyre të vogla ishte më domethënës. Siç pritej, nxënësit nga komunat e vogla ishin më të privuar nga mësimi online në krahasim me bashkëmoshatarët e tyre nga komunat e mëdha.

Sidoqoftë, një kufizim i madh i studimit është se numri i nxënësve jo pjesëmarrës në mësimin online, përfshirë hendekun gjinor, është vështirë të përcaktohet në kushtet në të cilat është mbajtur mësimi online. Masa e parë e ndërmarrë nga Ministria e Arsimit për t'iu përgjigjur mbylljes së shkollave ishte transmetimi televiziv i klasave. Nga ana tjetër, orët online nuk ishin të detyrueshme. Si i tillë, mësimi online u organizua kryesisht bazuar në oraret personale të mësimdhënësve dhe kishte shumë raste kur mësimdhënësit udhëzonin vetëm detyra shtëpie pa organizuar orë online. Kjo ndodhi për shkak të mungesës së një politike kombëtare dhe një platforme të përbashkët ose të unifikuar për të vazhduar me mësimin online të përcaktuar nga Qeveria.

Prandaj, rekomandohet një hulumtim i mëtejshëm dhe më i thellë rreth organizimit të mësimit online në Kosovë. Në këtë drejtim, do të ishte interesante që informacioni dhe të dhënat të vinin drejtpërdrejt nga mësuesit ose drejtuesit e shkollave dhe jo vetëm nga komunat.

IMPLIKIMET E POLITIKAVE

Nga perspektiva e politikë-bërjes, shihet qartë se ndërhyrjet, të cilat adresojnë jo vetëm pjesëmarrjen por edhe aftësitë digjitale dhe mësimin online në përgjithësi, janë po aq faktorë të rëndësishëm në mbarëvajtjen e mësimit në distancë sa edhe kyçja dhe të mbuluarit digjital. Mbyllja e hendekut gjinor në mësimin në distancë nuk është e paarritshme por duhet të përshpejtohet si progres. Angazhimi i ministrave të G20 të deleguar për të adresuar përfshirjen digjitale gjinore, Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm (QZHQ) si dhe masat e hartuara për të adresuar shkaqet themelore të kësaj ndarjeje janë hapa të rëndësishëm në drejtimin e duhur.

Një politikë tjetër shumë e rëndësishme që do të përshpejtonte zbatimin si dhe rritjen e pjesëmarrjes në mësimin në distancë është hartimi i udhëzimeve administrative që do ta bënin mësimin në distancë të detyruar siç është ai tradicional. Një detyrim i tillë, i rregulluar me udhëzues përkatës, do të çonte në ndërhyrje më të shpejta si nga ana e akterëve të arsimit të thirrur për të mbuluar nevojat për paisje digjitale dhe shërbim kulatiativ në mësimdhënien online, ashtu edhe nga ana e kërkeses për këto shërbime. Kjo pra do të shtynte palët e interesit në arsim të përmbushin nevojat për pajisje digjitale, aftësi digjitale dhe zhvillimin profesional të mësuesve në mësim në distancë.

LLOGARITJET SHTESË

TABELA 4. Përqindja e nxënësve jo-pjesëmarrës në mësimin në distancë sipas nivelit të shkollës dhe Komunës

2019/2020	Primare			Sekondare			Totali		
Komunat									
Komunat e Mëdha	M	F	Total	M	F	Total	M	F	Total
Prishtinë	7.24%	6.71%	6.45%	8.08%	7.85%	7.96%	6.66%	7.01%	6.83%
Prizren	0.95%	1.95%	1.44%	0.03%	0.19%	0.10%	0.72%	1.53%	1.11%
Pejë	4.63%1	2.72%6	3.71%	6.51%	1.14%	3.83%	5.10%	2.31%	3.74%
Gjakovë	5.33%	3.50%	4.47%	9.54%	2.62%	6.18%	6.45%	3.26%	4.93%
Mitrovicë	5.61%	5.32%	5.46%	1.70%	1.59%	1.64%	4.57%	4.22%	4.39%
Gjilan	7.17%	3.27%	5.26%	2.55%	1.10%	1.82%	5.81%	2.60%	4.22%
Ferizaj	2.85%	2.41%	2.63%	//	//	//	2.06%	0.85%	2.63%
Komunat e Vogla									
Obiliq	6.89%	6.67%	6.78%	5.00%	4.77%	4.77%	6.52%	6.27%	6.40%
Fushë Kosovë	7.12%	7.71%	7.40%	//	//	//	5.89%	6.21%	7.40%
Klinë	8.05%	6.85%	7.45%	3.10%	2.43%	2.43%	6.97%	5.71%	6.34%
Kamenicë	2.89%	1.94%	2.42%	1.52%	1.77%	1.77%	2.50%	1.97%	2.24%
Vushtri	8.01%	8.32%	8.16%2	5.04%	6.18%	6.18%	5.60%	6.24%	5.903
Total	5.05%	4.59%	4.83%	4.75%	4.09%	4.09%	4.86%	4.20%	4.66%

Burimi: Llogaritjet e autorëve bazuar në numrin e përgjithshëm të nxënësve të regjistruar dhe numrin e raportuar të ayrte që nuk kanë vijuar mësimin gjatë pandemisë sipas komunave

BIBLIOGRAFIA

- Education Cannot Wait (2020). Covid and Education in Emergencies. https://www.educationcannotwait.org/covid-19/
- Education Management Information System, Ministry of Education, Science, and Technology. (2019). Statistical Notes, Data on Pre-University Educationhttps://masht.rks-gov.net/uploads/2019/08/education-statistics-2018-2019.pdf
- Gutierres, K., (2016). Facts and Stats That Reveal The Power Of eLearning [Infographic], Disruptive Learning, Shift. https://www.shiftelearning.com/blog/bid/301248/15-facts-and-stats-that-reveal-the-power-of-elearning Kosovo Agency of Statistics (2020). Demographic and Education Data https://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/en/askdata/askdata__01%20Education__09%20Annex/edu35.px/?rxid=81b74478-fea6-471c-947a-f9295d58e16
- Livingstone, S. et al. (2017). Young adolescents and digital media: uses, risks and opportunities in low- and middle-income countries: a rapid evidence review. Gage, London, UK. http://eprints.lse.ac.uk/83753/1/Livingstone_Young_Adolescents_Digital_Media.pdf
- Malala Fund (2020). Girl's Education and COVID-19: What past shocks can teach us about mitigating the impact of pandemics. https://downloads.ctfassets.net/0oan5gk9rgbh/6TMYLYAcUpjhQpXLDgmdIa/dd1c2ad08886723cbad85283d479de09/GirlsEducationandCOVID19_MalalaFund_04022020.pdf
- Melnick, R. Shep. (2018). The Transformation of Title IX: Regulating Gender Equality in Education, Brookings Institution Press, ProQuest Ebook Central. http://ebookcentral.proquest.com/lib/ucalgary-ebooks/detail.action?docID=5179998.
- The World Bank (2012). Kosovo: Gender Gaps in Education, Health and Economic Opportunities. https://openknowledge.worldbank.org/handle/10986/26830
- The World Bank (2020). Gender Data Portal, Education Data https://www.worldbank.org/en/data/datatopics/gender/topics/education
- UNESCO (2020) Education and Gender Equalityhttps://en.unesco.org/themes/education-and-gender-equality
- UNESCO (2020). COVID-19 Education Response, Addressing he gender dimensions of COVID-related school closures https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000373379/PDF/373379eng.pdf.multi
- UNESCO (2020). COVID-19 Education Response, How many students are at risk of not returning to school?https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000373992/PDF/373992eng.pdf.multi
- UNICEF (2020). Unicef Data, Gender Equality and Covid-19. https://data.unicef.org/topic/gender/covid-19/United
- Nations (2020). Policy Brief, Education during Covid-19 and Beyond. https://www.un.org/development/desa/dspd/wp-content/uploads/sites/22/2020/08/sg_policy_brief_covid-19_and_education_august_2020.pdf

2020/2

KCDE - Mëso Online
Kosova Center for Distance Education

Canada